



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

04.Nr.1.dt.24.05.2018

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Në bazë të nenit 64 pika (b), të Statutit të Komunës, nr.001/3127 të datës 30.09.2010, dhe pikës 2 të Rregullorës për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, nr. 02-343/16 të datës 23.12.2016, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim nxorri këtë:

NJOFTIM

Sipas aktivendimeve që kanë pranuar pronaret e Veprimtarive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Komunën e Junikut, të datës 28.04.2018, jeni të obliguar që në afat prej 15 ditësh të bëni pagesën në emër të taksës Komunale për ushtrim të veprimtarisë konform rregullores Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoha të Junikut të datës 30.12.2016.

Andaj me këtë vërejtje të fundit nga ana jonë ju detyroheni që të bëni pagesë e taksës për ushtrim të veprimtarisë në afat prej 15 ditësh.

Në të kundërtën Komuna e Junikut detyrohet që pagesën tuaj ta realizoj përmes përmbaruesve privat, pas skadimit të afatit kohor prej 15 ditësh.

Inkasimi i këtyre taksave do të bëhet përmes Xhirollogarisë Nr. 1000650100000085 në BQK- në afat prej 15 ditëve, nga dita e shpalljes së këtij Njoftimi.

Në rast të mos përmbushjes së detyrimit në afatin e caktuar ndaj obliguesve do të merren masa administrative përmes përmbaruesve privat.

ARSYETIM

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Junikut, në bazë të nenit 64 pika B, të Statutit të Komunës, dhe të pikës 2 të rregullorës për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale nr. 02-343/16 të dt. 23.12.2016 tarifa 2 pika 2.5.1 të Rregullorës për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale ka përcaktuar ngarkesat për ushtruesit e veprimtarive sipas kriterit të përcaktuar në dispozitivin e Aktvendimit.

Nga sa u tha më lartë në kuptim të pikës 2 Tarifa 2.5.1, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Drejtori

Leonard Ljollani

